

D E K R E T
Nr.1578, datë 13.8.1996

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7599, DATE 2.9.1992 “KODI DOGANOR I
REPUBLIKËS SË SHQIPERISË” ,NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8020, DATË 1.11.1995**

Në mbështetje të nenit 28, pika 19, të ligjit nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese”, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

D E K R E T O J:

Neni 1

Në ligjin nr. 7599, datë 2.9.1992 “Kodi doganor i Republikës së Shqipërisë”, neni 10 ndryshohet si vijon:

“Mallrat që ndalohen të hyjnë a të dalin nga territori i Republikës së Shqipërisë ose kur këto mallra i nënshtrohen një regjimi të veçantë importimi, eksportimi a tranzitimi, për arsye të sigurisë kombëtare, shoqërore, mbrojtjes së shëndetit e të jetës së njerëzve, kafshëve, bimëve, mbrojtjes së shëndetit e të jetës së njerëzve, kafshëve, bimëve, mbrojtjes së pasurisë kombëtare e të mallrave që kanë vlera shkencore, artistike, historike e arkeologjike, si dhe mbrojtjes së pronësive industriale e tregtare, kur nuk parashikohen me ligj, caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave”.

Neni 2

Neni 13 ndryshohet si vijon:

“Të gjitha mallrat që kalojnë në dhe nga territori doganor i Republikës së Shqipërisë, duhet të paraqiten menjëherë në zyrën doganore nga pronari, poseduesi, personi që i ka sjellë a që i ka në dorëzim ose nga përfaqësuesi i tyre”.

Neni 3

Mbas nenit 13 shtohet neni 13/1 me këtë përmbajtje:

“1. Mallrat e paraqitura në zyrën doganore, sipas kuptimit të nenit 13, duhet të deklarohen me shkrim në një formular (deklaratë) të miratuar nga ministri i Financave.

Për armatimin, teknikën dhe pajisjet luftarake forma dhe mënyra e deklarimit të tyre në zyrën doganore do të përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Në pikën doganore kufitare deklarimi bëhet për mallin në sasi, cilësi, lloj dhe çmim.

Deklaruesi, për deklarimin e bërë, mban përgjegjësi për kundërvajtje administrative, në përputhje me nenet 62 e 70 të Kodit Doganor, si dhe përgjegjësi penale, kur janë kushtet e parashikuara në nenin 63 të këtij Kodi”.

Neni 4

Shtohet neni 13/2 me këtë përmbajtje:

“Deklaruesi, në pikën doganore kufitare, me kërkesën e tij mund të ndryshojë një ose më shumë të dhëna të dokumenteve të mallit, duke kërkuar verifikimin e mallit, përpara se t’i dorëzojë organit doganor deklaratën e tranzitit.

Deklaruesit nuk i lejohet ndryshimi i të dhënave në dokumentet shoqëruese të mallit, si dhe verifikimi i tij në rastet kur organi doganor:

- ka njoftuar deklaruesin se do të kontrollojë mallin;
- ka arritur në përfundimin se të dhënat e deklaruesit janë të pasakta;
- ka lejuar tranzitimin e mallrave”.

Neni 5

Neni 38 ndryshon si:

“1. Mallrat e importuara a të eksportuara deklarohen në detaje në zyrën doganore të destinacionit nga pronari ose poseduesi.

Këta të fundit i japin të drejtë të plotë, përkundrejt një prokure, përfaqësuesit ose agjentit doganor të kryejë formalitetet dhe deklarimin në emër të tyre. Ministri i Financave përcakton me udhëzim të veçantë statusin e agjentit doganor.

Formulimet e bëra në deklaratën doganore ngarkojnë me përgjegjësi nënshkruesin.

2. Në zonën doganore të destinacionit nuk mund të deklarohet ndryshe nga deklarimi i bërë në pikën doganore kufitare ose në pikën doganore të nisjes. Deklaruesit nuk i lejohet të kërkojnë që deklarata e detajuar të zbatohet për mallra në sasi, cilësi, lloj dhe çmim të ndryshme nga ato të deklaruara në pikën doganore kufitare”.

Neni 6

Neni 42 ndryshon si vijon:

“Personi që ka depozituar një deklaratë të detajuar, në kushte të caktuara, mund ta korrigjojë atë.

Kërkesa për korrigjim duhet bërë përpara se të verifikohet malli ose përpara se deklaruesi të jetë vënë në dijeni nga organi doganor se do të bëhet kontrolli fizik i mallrave të deklaruara.

Nuk lejohet korrigjimi i deklaratës së detajuar, kur kërkohen ndryshime në sasi, lloj, cilësi dhe çmim të mallit të deklaruar në pikën kufitare doganore ose në pikën e nisjes për rastet e eksportit”.

Neni 7

Neni 52, paragrafi i parë ndryshon si vijon:

“Mallrat e importuara përkohësisht, sipas drejtimit të përdorimit në territorin doganor, pas lëshimit të autorizimit përkatës nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, vendosen nën regjimin e lejimit të përkohshëm:

a) Me pezullim total nga pagimi i detyrimeve doganore.

b) Me përjashtim pjesor për makineri dhe pajisje, duke paguar 5% të detyrimeve doganore çdo muaj, pas përfundimit të afatit njëvjeçar të regjimit të lejimit të përkohshëm.

Nuk përfshihen në këtë pikë makineritë dhe pajisjet që përjashtohen me ligj nga pagimi i taksave”.

Neni 8

Në nenin 62 bëhen këto ndryshime:

1. Pika 4 ndryshon si vijon:

“Gjetja e mallrave të padeklaruara ose mospërputhja e dokumenteve shoqëruese të mallit me gjendjen faktike të tij në sasinë, cilësinë dhe llojin e tyre, kur nuk përbëjnë vepër penale”.

2. Shtohet pika 10 me këtë përmbajtje:

“Gjetja e mallrave në anije, të paregjistruara në manifest ose në listën e përgjithshme të ngarkesës së anijes”.

Neni 9

Pika 1 e nenit 70 ndryshohet si vijon:

“Të gjitha rastet e kundërvajtjeve të përcaktuara në nenin 62 të këtij Kodi, me përjashtim të pikës 4, si dhe rastet e tjera të shkeljes së dispozitave ligjore e nënligjore, të cilat nuk përbëjnë kontrabandë ose ndonjë vepër tjetër penale, dënohen nga organet doganore me gjobë 20.000 deri në 50.000 lekë, si dhe me sekuestrimin e mallit objekt kundërvajtjeje ose të vlerës së tij.

Për kundërvajtjet e parashikuara në pikën 4 të nenit 62, organet doganore bëjnë sekuestrimin e mallit objekt kundërvajtjeje ose të vlerës së tij, të mjetit të transportit, si dhe vendosin gjobë sa dyfishi i detyrimit doganor; kur mjeti, në të cilin gjenden mallra objekt kundërvajtjeje, rezulton në pronësi të një të treti, ai nuk sekuestrohet, por vendoset një gjobë nga 30.000 lekë deri në 50.000 lekë.

Ministri i Financave cakton kritere më të detajuara për masën e gjobës sipas llojit të kundërvajtjes, si dhe për mënyrën e llogaritjes së vlerës të mallit kundërvajtje”.

Neni 10

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë. Për pikën “b” të nenit 7 efektet financiare në mbajtjen e detyrimit doganor fillojnë nga data 1 janar 1996.

KUNDËRFIRMOHET
KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
Sali Berisha